

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7123
E enjte, 22 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Për çfarë po aventurizohet partneriteti me ShBA-në? FAQE 7



Shkruan: Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA: KUVENDI VAZHDON TË MBETET NË NJË PERIUDHË SFIDUESE FAQE 4-5



Të mërkurën ka dështuar të mbledhet Kryesia e Kuvendit të Kosovës për shkak të kuorumit. Kryeparlamentari Glauk Konjufca, konform kompetencave të tij

kushtetuese dhe në konsultim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbledhet në seancë të enjten. Ndërkaq partitë e opozitës kanë

theksuar se Kuvendi po vazhdon të mbetet në një periudhë sfiduese. Sipas opozitës, janë 62 pika të rendit të ditës që presin për t'u diskutuar në seancat plenare

OSMANI TAKON AMBASADORËT E AKREDITUAR NË PRISHTINË, KËRKON HEQJEN E MASAVE TË BE-së NDAJ KOSOVËS F. 3



KONJUFCA: RAPORTET KOSOVË - SHBA NUK JANË PËR T'U SHOQETËSUAR F. 5



AKTUALE




BE-ja APROVON PAKON E 13-të ME SANKSIONE KUNDËR RUSISË F. 2

VON DER LEYEN PREMTON MBËSHTETJE PËR ZGJERIMIN NËSE RIZGJEDHET NË KRYE TË KE-së F. 3

LIMAJ TAKON AKTIVISTËT E NISMËS NË MALISHEVË: BASHKËRISHT I ARRITËM PËR NJË DEKADË F. 6


EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI THOTË SE RREGULLORJA E RE E BQK-së PËRAFRON KOSOVËN ME STANDARDET E BE-së F. 7

KURTI: BUXHETI I KOMUNAVE PËR VITIN 2024 ARRIN NË 742 MILIONË EURO F. 7

SPORT



DRITA MPOSHT BALLKANIN, GARA PËR TITULL BËHET EDHE MË INTERESANTE F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja aprovon pakon e 13-të me sanksione kundër Rusisë

BRUKSEL, 21 SHKURT - Bashkimi Evropian (BE) e ka miratuar të mërkurën pakon e 13-të të sanksioneve kundër Rusisë, njoftoi presidenca belge në rrjetin

social "X". "Ambasadorët e BE-së sapo u pajtuan në parim për pakon e 13-të të sanksioneve në kornizën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës", tha presidenca

belge. Kjo është një prej pakove "më të gjera" të sanksioneve të BE-së kundër Rusisë, sipas saj. Gati 200 subjekte dhe individë janë futur në listën e sanksioneve

me pakon e re. Pakoja do të aprovohet formalisht në kohë për përvjetorin e dytë të fillimit të pushtimit të Ukrainës nga Rusia më 24 shkurt.



Stoltenbergu: Navalny nderohet më së miri nëse mposhtet Rusia në Ukrainë



BRUKSEL, 21 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, thotë se vdekja e politikanit opozitar rus Alexei Navalny si dhe përfitimet e para të Rusisë në fushëbetëje pas shumë muajve, duhet ta ndihmojnë aleancën ushtarake dhe aleatët e saj t'i kushtojnë vëmendje nevojës urgjente për ta mbështetur Ukrainën. Në një intervistë me "Radion

Evropa e Lirë" në Bruksel, shefi i NATO-s tha se tërheqja e forcave ukrainase nga qyteti i Avdivkës pas shumë muajve luftimesh dëshmon nevojën për më shumë ndihma ushtarake "për t'u siguruar se Rusia nuk fiton më shumë territor". Vdekja e Navalnyt në një burg në Arktik të premtën më 16 shkurt nën rrethana të

dysshimta e rrit nevojën për t'u siguruar që sundimi autoritar i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, nuk kalon pa u kontrolluar. "Unë besoj fuqishëm se mënyra më e mirë për ta nderuar kujtimin e Alexei Navalnyt është të sigurohem se presidenti Putin nuk fiton në fushëbetëje, por që Ukraina të triumfojë", ka theksuar Stoltenbergu.

Mbi 45 000 ushtarë rusë besohet se janë vrarë prej fillimit të luftës në Ukrainë

KIEV, 21 SHKURT - Së paku 45 123 ushtarë rusë janë vrarë prej se Moska e nisi pushtimin e Ukrainës para gati dy vjetëve, sipas një hulumtimi nga Mediazona dhe Shërbimi rus i BBC-së, të cilat i kanë identifikuar ushtarët e vdekur. Dy e treta e të gjithë të vrarëve të konfirmuar - vullnetarë, rekrutë, ish-të burgosur dhe luftëtarë nga kompanitë ushtarake

private nuk kishin lidhje me ushtrinë para se të niste pushtimin, ka gjetur hulumtimi. Këtu përfshihen 5 406 ushtarë të mobilizuar, 80 për qind e të cilëve u vranë në vitin e dytë të luftës. Krasnodar, Sverdolvsk, Bashkortostan dhe Çelabinsk janë rajonet me numrin më të madh të të vdekurve. Gazetarët i kanë identifikuar 27

906 ushtarë rusë të vrarë vitin e kaluar, 57 për qind më shumë se humbjet e konfirmuara në vitin e parë të pushtimit. Nga tetori i vitit të kaluar deri këtë muaj, kryesisht në periudhën gjatë së cilës forcat ruse u futën në qytetin industrial Avdivka dhe në zonat përreth në rajonin e Donjeckut - hulumtuesit e konfirmuan vdekjen e 6 614 ushtarëve rusë.



Bujqit në Greqi protestojnë para Parlamentit kundër çmimit të naftës

ATHINË, 21 SHKURT - Bujqit grekë kanë protestuar duke u rënë borive të traktorëve të tyre pranë ndërtesës së Parlamentit grek të mërkurën, pasi e kaluan natën në qendër të Athinës për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të karburantit dhe kostos së prodhimit për të dytën ditë radhazi.

Së paku 8 000 bujq, bletarë dhe mbarështues të blegtorisë, iu bashkuan protestës në sheshin "Syntagma" të martën, duke u bërë jehonë protestave të ngjashme nëpër Evropë.



Shumë prej tyre e kaluan natën në shesh para se të fillonin të lëviznin të mërkurën. "Ne e morëm këtë

vendim dhe tani po presim rezultatin", tha bujku Konstantinos Kyriakopoulos, 34

vjeç, nga rajoni jugor i Greqisë, Mesinia.

Bujqit thonë se janë prekur edhe nga ndryshimi klimatik, pasi vërshimet e paparashikueshme, të nxehtit ekstrem dhe zjarret janë duke e bërë punën e tyre edhe më të rrezikshme. Ata i kanë bllokuar shkurtimisht rrugët dhe pikëkalimet për disa javë, derisa sindikatat e tyre kanë biseduar me qeverinë konservatore të kryeministrit Kyriakos Mitsotakis për ndihmë financiare. Qeveria u ka ofruar atyre deri tani zbritje në faturën e rrymës dhe

zgatjen e zbritjes tatimore për naftën në bujqësi deri në fund të vitit 2024.

Qeveria greke ka thënë se është e gatshme të bisedojë për një skemë të përhershme për zbritje tatimore, por nuk ka shanse për koncesione shtesë këtë vit.

Në Indi policia përdori gaz lotsjellës të mërkurën për t'i shpërndarë mijëra bujq protestues, të cilët kërkuan ta rifillonin një marsh në Nju-Delhi, pasi e hodhën poshtë një ofertë të weverisë për çmimet e produkteve të tyre.

Thellohet kriza e shëndetit publik në Gazë

Gaza, 21 shkurt - Palestinezët që kanë arritur të ikin prej sulmeve të Izraelit në veri të Gazës, tani në jug po përballen me mungesë të ushqimit, ilaçeve dhe

produkteve higjienike. Për popullsinë në Rafah, secila ditë është kthyer në cikël të vazhdueshëm të kërkimit për bukë dhe ujë. Autoritetet shëndetësore në

Gazë kanë thënë se rreth 29 000 palestinezë janë vrarë prej nisjes së ofensivës tokësore dhe ajrore të Izraelit në Gazë, e nxitur nga sulmet ndaj Izraelit më 7 tetor 2023

nga grupi ekstremist palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.



Opozita: Kuvendi vazhdon të mbetet në një periudhë sfiduese

Të mërkurën ka dështuar të mblidhet Kryesia e Kuvendit të Kosovës për shkak të kuorumit. Kryeparlamentari Glauk Konjufca, konform kompetencave të tij kushtetuese dhe në konsultim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mblidhet në seancë të enjten. Ndërkaq partitë e opozitës kanë theksuar se Kuvendi po vazhdon të mbetet në një periudhë sfiduese. Sipas opozitës, janë 62 pika të rendit të ditës që presin për t'u diskutuar në seancat plenare

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 SHKURT - Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e paraparë që të mbahet të mërkurën, nuk u mbajt në mungesë të kuorumit. Rrjedhimisht, kryetari Glauk Konjufca, konform kompetencave të tij kushtetuese dhe në konsultim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mblidhet në seancë të enjten, për të vijuar me trajtimin e pikave të mbetura nga seancat e 8 dhe 14 shkurtit.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se me 62 çështje (pika) ende pa u zgjidhur,

Kuvendi vazhdon të mbetet në një periudhë sfiduese. "Dështimi i seancave plenare thekson nevojën për ta rikthyer rendin parlamentar, LV ka dështuar. Koha e LDK-së po vjen", ka thënë Gashi. Pas dështimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se janë mbledhur 62 pika të rendit të ditës. "Si e patë edhe sot dështoi mbledhja e kryesisë. Janë mbledhur 62 pika dite. Kjo agjendë tani ka disa ligje e prej tyre disa janë të reja që prekin qytetarët. Si Aleancë jemi duke punuar që të enjten pikë të parë ta kemi seancën e jashtëzakonshme me 40



nënshkrime për trajtimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore. Kosova ka shumë probleme që kërkojnë zgjidhje, por një prej pikave që kërkojnë trajtim urgjent është sigurimi shëndetësor për qytetarët e Kosovës", ka thënë Tahiri. Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, konsideron se ka degraduar puna në Kuvendin e Kosovës, pasi po

zvarriten shumë pika të rendit të ditës. "Nuk kishte kuorum për mbledhje. Po shohim se ka një degradim të punës. Janë disa pika që presin të shqyrtohen e ne kemi zvarritje në punën e institucionit. Javën e ardhshme PDK-ja do ta shqyrtojë migrimin e qytetarëve të Kosovës. Do të shohim nëse qeveria do të jetë aty", ka thënë ajo. Deliu-Kodra përmendi edhe

sanksionet që i janë vënë Kosovës, duke thënë se aleatët ndërkombëtarë duhet të ruhen. "Ne kemi shënuar javën e kaluar përvjetorin e pavarësisë. Nuk ka pasur asnjëherë përvjetor më të zbehtë. Edhe sanksionet që i ka Kosova tash e sa kohë do të ishte e udhës të hiqen. Partneriteti duhet të forcohet, aleatët duhet të ruhen", ka thënë deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra.

Von der Leyen premton mbështetje për zgjerimin nëse rizgjidhet në krye të KE-së

PRISHTINË, 21 SHKURT - Presidentja aktuale e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, së cilës i skadon mandati në fund të vitit, është paraqitur të mërkurën si kandidate udhëheqëse e Partisë Popullore Evropiane (EPP) për një mandat të ri pesëvjeçar.

Kandidatura e Von der Leyenit është shpallur nga Manfred Weber, shef i këtij grupimi politik të qendrës së djathtë evropiane, që është grupi më i madh në Parlamentin Evropian.

Presidentja e KE-së ka premtuar se, nëse fiton edhe një mandat, do ta vazhdojë punën në shumë fusha në të cilat ka punuar edhe në mandatin e tashëm, përfshirë edhe në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe në asistencën financiare për vendet e Ballkanit Perëndimor. "Gjithmonë kam qenë mbështetëse e fuqishme e zgjerimit të BE-së. Por, në të njëjtën kohë, kam shtuar qartë se ky do të mbetet proces i bazuar në meritat individuale", ka thënë Von der Leyen më 21 shkurt.

"Mbetem e përkushtuar ndaj këtij parimi, por jam, po ashtu, e lumtur se vendet e Ballkanit Perëndimor, po ashtu edhe Ukraina, Moldavia, po bëjnë gjithçka që po mundën për t'i kryer reformat e nevojshme dhe për të lëvizur drejt Bashkimit Evropian", ka shtuar ajo.

"Do të më shihni edhe në



mandatin e ardhshëm si mbështetëse të fuqishme të zgjerimit dhe të Ballkanit Perëndimor", ka deklaruar Von der Leyen.

Duke shpallur kandidaturën

për një mandat të ri, Von der Leyen ka thënë se "plani për rritje është mesazh i qartë. Kemi fondet dhe kjo është e rëndësishme. Kemi mjetet dhe tash jemi në proces të definimit të detajuar të

planit për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, për të parë se cilat reforma janë të nevojshme për secilin vend, si kusht për këtë plan, si do t'i përdorim dhe si do t'i përfshijmë

ato vende në tregun tonë të përbashkët".

"Puna po shkon shumë mirë dhe kemi një entuziazëm të madh nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Sapo të përmbushen kushtet bazike, pagesat e para do të mund të realizohen shpejt", është shprehur ajo.

Von der Leyen ka thënë, po ashtu, se edhe nëse fiton mandatin e ri, do ta vazhdojë mbështetjen për Ukrainën dhe se nuk do të bashkëpunojë me miqtë e presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, as me ata që janë kundër BE-së dhe kundër Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO).

Sipas parimit të njohur si "Spitzen kandidat" (Kandidati udhëheqës), grupimet politike evropiane, në prag të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, shpallin kandidatin e tyre për president të Komisionit Evropian. Partia që fiton shumicën e vendeve në Parlamentin Evropian kërkon pastaj që kandidati i saj të fitojë postin në krye të Komisionit.

Por, kjo varet edhe nga liderët e vendeve anëtare, të cilët duhet ta zgjedhin kreun e Komisionit Evropian, që më pas konfirmohet nga shumica e deputetëve në Parlamentin Evropian.

Zgjedhjet evropiane në 27 vende anëtare zhvillohen nga 6 deri më 9 qershor 2024.



Osmani takon ambasadorët e akredituar në Prishtinë, kërkon heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

Presidentja Vjosa Osmani në takim me shëfën e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ambasadorin e Italisë, Antonello De Riu dhe zëvendësambasadorin e Gjermanisë, Mathias Conrad, ka theksuar nevojën e heqjes së masave të BE-së ndaj Kosovës, të cilat, sipas saj, janë të padrejta dhe krijojnë mungesë ekuilibri në dialog. Ajo njëkohësisht theksoi se Kosova ka ndërmarrë hapa konkretë në përputhje me planin për këtë çështje

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të mërkurën në takim shëfën e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ambasadorin e Italisë, Antonello De Riu dhe zëvendësambasadorin e

Gjermanisë, Mathias Conrad, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet aktuale në fushën e politikës dhe atë të sigurisë. Në këtë takim është diskutuar lidhur me përgatitjet që po bëhen për mbajtjen e zgjedhjeve në të katër komunat në veri të vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Presidentja ritheksoi se e drejta për ta kërkuar largimin e

kryetarëve nëpërmjet nënshkrimeve është e drejtë që u takon qytetarëve dhe se tani pret që në KQZ të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme në përputhje me ligjin dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Në takim me ambasadorët, presidentja Osmani ka theksuar nevojën e heqjes së masave të BE-së ndaj Kosovës, të cilat janë të padrejta dhe

krijojnë mungesë ekuilibri në dialog. Njëkohësisht ajo theksoi se Kosova ka ndërmarrë hapa konkretë në përputhje me planin për këtë çështje. Heqja e masave, theksoi ajo, do të krijonte atmosferë shumë më pozitive për vazhdimin e dialogut parimor ku të dyja palët do të trajtoheshin të barabarta.

Për më tepër, gjatë takimit ajo ritheksoi se, për fat të keq, Serbia nuk po përballet me përgjegjësi për nxitjen e sulmit ndaj ushtarëve të KFOR-it në maj e as për sulmin e agresionit kundër Kosovës në shtator të vitit të kaluar. Kjo situatë, sipas saj, mund ta nxisë Serbinë që t'i shtojë veprimet destabilizuese në rajon.

Një pjesë e takimit iu kushtua

edhe çështjes së zbatimit të Rregullores së BQK-së, me ç'rast presidentja ritheksoi se është me rëndësi që nuk po kërkohet që kjo rregullore të shfuqizohet, por thjesht të punohet në një plan tranzicioni për zbatimin e saj e cila merr parasysh edhe shqetësimet e të gjithë qytetarëve që mund të afektohen nga një vendim i tillë.

Duke ritheksuar rëndësinë e zbatimit të Kushtetutës në çdo cep të Kosovës, presidentja Osmani ka shtuar se sukcesi në këtë drejtim është i lidhur edhe me nivelin e bashkëpunimit me aleatët tanë të cilët kanë qenë gjithnjë mbështetësit më të fuqishëm të pavarësisë, sovranitetit dhe sigurisë së shtetit tonë.

Krasniqi me ambasadorin jorezident të Kanadasë: PDK-ja do t'i ruajë raportet e mira me të gjitha shtetet mike

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka pritur në takim të mërkurën ambasadorin jorezident të Kanadasë në Kosovë, Jessica

Blitt, me të cilën ka diskutuar rreth aktualitetit politik në vend dhe thellimit të partneritetit mes dy shteteve tona. "Ambasadores Blitt i shpreha mirënjohjen për mbështetjen e

vazhdueshme të Kanadasë dhënë Kosovës, sidomos në rrugëtimin e shtetit tonë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Në këtë takim theksova se Partia Demokratike

e Kosovës do të vazhdojë të përkushtohet për krijimin dhe ruajtjen e raporteve të mira me të gjitha shtetet mike të vendit tonë", ka thënë Krasniqi pas takimit.



Bislimi paralajmëron masa që “qytetarët të mos dëmtohen” nga ndalesa e dinarit

PRISHTINË, 21 SHKURT - Zëvendës-kryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se Qeveria e Kosovës shpejt do të paraqesë dhjetë masa lidhur me mënyrat se si qytetarët të mos dëmtohen gjatë “fazës kalimtare” të zbatimit të vendimit, që ndalon përdorimin e dinarit serb për kryerjen e pagesave.

Që nga 1 shkurti në Kosovë ka hyrë në fuqi rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës që parashihet euron si valutën e vetme në Kosovë për kryerjen e pagesave me para të gatshme.

Gjatë një tryeze me temën “Zhvillimi ekonomik për serbët në Kosovë”, Bislimi tha se janë të vetëdijshëm për vështirësitë që mund të krijojë rregullorja e BQK-së të serbët në Kosovë. “Ne jemi të vetëdijshëm që në afat të shkurtër zbatimi i kësaj mase mund të krijojë vështirësi për një pjesë të qytetarëve të cilët kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin mbështetje financiare nga Republika e Serbisë. Banka Qendrore [e Kosovës] ka nxjerrë një varg aktivitete dhe masash përmes të cilave synon ta zbusë këtë ndikim”, tha Bislimi. “Por, në ditët në vijim edhe Qeveria e Kosovës do të dalë me një listë prej dhjetë masash përmes të cilave ne do të tregojmë se si do të kujdesemi që qytetarët të mos dëmtohen në këtë fazë kalimtare, por fazë e cila do të garantonte pastaj zbatimin në plotëni të sistemit të pagesave”, tha ai.



Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Në vende të caktuara në Graçanicë qytetarët serbë më 20 shkurt nuk kanë mundur ta marrin ndihmën sociale dhe shtesat për fëmijë në postë, që

punon sipas sistemit serb, sepse punonjësit u kanë thënë se nuk kanë para për t'i paguar këto shtesa.

Po ashtu, më 21 shkurt një grup i mësimdhënësve në Mitrovicë të Veriut protestuan para Kursimores së Postës së Serbisë, pasi nuk morën pagat. Beogradi e ka kritikuar ashpër

rregulloren e BQK-së, duke e interpretuar si synim të Qeverisë së Kosovës për dëbim të serbëve. Rregullorja e BQK-së është kritikuar edhe nga faktori ndërkombëtar që ka thënë se vendimi është marrë pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimin të komuniteti serb.

Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar që Kosova ta shtyjë zbatimin e vendimit, duke argumentuar se mospërbushja e kësaj kërkesë veçse ka ndikuar te cilësia e raporteve mes Uashingtonit dhe Prishtinës.

BQK-ja ka thënë se vendimi do të zbatohet përmes një faze tranzitorejo më të gjatë se tre muaj.

Konjufca: Raportet Kosovë - ShBA nuk janë për t'u shqetësuar



PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk janë për t'u shqetësuar. Në një deklaram për medie të mërkurën, Konjufca është shprehur se nuk ka nevojë të bëhet panik për këtë çështje. Kryeparlamentari ka deklaruar se vërejtjet e ShBA-së nuk kanë të bëjnë me legalitetin e veprimeve të Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, sipas tij, kritikën e ShBA-së janë gjithmonë me vend, pasi “e shohin Kosovë në nivel shumë më të lartë sesa që e shohim ne”. “Unë mendoj që nuk janë raporte për t'u shqetësuar, për të bërë panik. Unë mendoj se

raportet janë përtej këtyre ndryshimeve në perceptim që e kemi se si të veprohet në pjesën e veriut të Kosovës. I mirëkuptojmë plotësisht ato vërejtjet dhe kritikën që na jep ShBA-ja. Janë gjithmonë kritika me vend, sepse ShBA-ja e sheh Kosovën në nivel shumë më të lartë sesa që e shohim ne, e shohin në rajon, e shohin edhe në Evropë e shohin edhe në kontekstin e përgjithshëm global”, është shprehur Konjufca. Ai ka thënë se është e drejtë e shtetit të Kosovës ta shtrijë sundimin e ligjit dhe sovranitetin në vend. “Kjo është perspektivë më e ulët, më e ngushtë, por është perspektivë e së drejtës së Kosovës për t'i kryer punët e veta”.

Tahiri: Marrëdhëniet e Kosovës me Unionin Evropian dhe ShBA-në kurrë nuk kanë qenë më të këqija

PRISHTINË, 21 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka folur të mërkurën rreth interesimit të medie për qëndrimin e AAK-së në marrëdhëniet e Kosovës me faktorin ndërkombëtar dhe çështjen e

dinartit. Tahiri ka theksuar se marrëdhëniet e Kosovës me Unionin Evropian dhe ShBA-në kurrë nuk kanë qenë më të këqija. Sa i përket dinarit, Tahiri ka theksuar se valuta në Kosovë është euroja, ndërsa dinari nuk ka vend të

qarkullojë në asnjë sistem të pagesave dhe në asnjë mënyrë të qarkullimit në Republikën e Kosovës. “Si e ka menaxhuar këtë çështje qeveria? Si çdo krizë tjetër, si çdo temë tjetër. Euroja në Kosovë është valutë nga

legalizimi i saj. Menaxhimi dhe trajtimi i kësaj teme e ka sjellë edhe një problem që po e dobëson Kosovën në marrëdhëniet bilaterale dhe se, në fund, Kurti do të lëshojë pe nga qëndrimet e tij”, është shprehur ai.



Limaj takon aktivistët e Nismës në Malishevë: Bashkërisht i arritëm për një dekadë

MALISHEVË, 21 SHKURT - Në prag të 10-vjetorit të themelimit të Nismës Socialdemokrate, kryetari i saj, Fatmir Limaj, ka takuar aktivistët në Malishevë dhe drejtuesit e udhëheqjes komunale në krye me kryetarin Ekrem Kastrati. Limaj me aktivistët e Nismës

kanë biseduar për rrugëtimin e tyre politik, sfidat dhe projektet, për të cilat lideri i kësaj partie ka theksuar se "bashkërisht i arritëm për një dekadë".

Më 24 shkurt Nisma Socialdemokrate feston 10-vjetorin e themelimit. Limaj së

bashku me Jakup Krasniqin dhe bashkëpunëtorë të tjerë themeluan këtë subjekt politik pas ndarjes nga PDK-ja.

Nisma ishte më herët pjesë e Kuvendit të Kosovës dhe pjesë e qeverisjes qendrore në vend. Aktualisht udhëheq komunën e Malishevës.



Vdekja e vajzës 4 vjeçe në Gjakovë, KOMF: Thirrje për hetim të menjëhershëm

PRISHTINË, 21 SHKURT - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF i cili përfaqëson 35 organizata joqeveritare, shpreh dhimbje dhe shqetësim të thellë për incidentin tragjik të ndodhur dje në Gjakovë, i cili përfundoi me vdekjen e një vajze katërvjeçare. KOMF ka theksuar se kjo ngjarje e paprecedent ngre pikëpyetje serioze për përbushjen e përgjegjësi njerëzore, mjekësore dhe etike të

profesionistëve të kujdesit shëndetësor. "Sipas raportimeve dhe dyshimeve të ngritura nga prindërit e vajzës të cilat janë transmetuar në media, e ndjera dyshohet se ka pësuar një sulm nga dy fëmijë të tjerë, duke u goditur me forcë në pjesën e shpinës dhe gjoksit, gjë që ka çuar edhe në rrëzimin e saj në rrugë. Me gjithë gjendjen e rënduar të fëmijës, prindërit janë shprehur se përgjigja mjekësore ndaj gjendjes së saj ka



qenë e pamjaftueshme. Ata pretendojnë se gjatë ditës së djeshme kanë kërkuar disa herë ndihmë mjekësore për vajzën e tyre, por kanë marrë vetëm disa këshilla sipërfaqësore nga ekipi mjekësor, duke nënvlerësuar tragjikisht ashpërsinë e gjendjes së saj. Sipas prindërve, vajza nuk ka marrë një ekzaminim të plotë mjekësor dhe trajtimi i duhur i saj është neglizhuar duke shkaktuar fatalitet, gjë që ngre shqetësim dhe pikëpyetje të

thella në lidhje me etikën profesionale të personelit mjekësor", theksohet në reagimin e KOMF-it. Nisur nga kjo ngjarje e rëndë, KOMF bën thirrje që institucionet përgjegjëse në përbushje të mandatit të tyre, ta trajtojnë me prioritet absolut rastin dhe t'i ndërmarrin në mënyrë të menjëhershme veprimet dhe masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

UP-ja dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 21 SHKURT - Universiteti i Prishtinës dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për t'i zhvilluar kapacitetet institucionale dhe për të ofruar më shumë mundësi për studentët.

Ky memorandum bashkëpunimi synon të mundësojë shkëmbimin e përvojave profesionale, trajnimeve dhe angazhimin e studentëve në projektet e ARRU-

së, duke përafruar fushat e inxhinierisë, ekonomisë, drejtësisë dhe programe të tjera akademike.

UP-ja dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit angazhohen për t'i zhvilluar ekspertizat, analizat dhe studimet e përbashkëta, duke adresuar sfidat dhe duke përmirësuar praktikën profesionale në fushën e tyre të veprimtarisë.

Me këtë marrëveshje palët

shprehin vullnetin e tyre për t'i përgatitur dhe avancuar profesionistët e ardhshëm për tregun e punës në Kosovë.

Rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, dhe drejtoresha e ARRU-së, Hajrije Morina, theksuan se ky bashkëpunim do të sjellë përparim në fushën e arsimit dhe shërbimeve publike në Kosovë, duke përgatitur dhe avancuar profesionistët e ardhshëm për tregun e punës në Kosovë.

Komisioni për emërtimin e rrugëve në Deçan del në terren, verifikon kërkesat

DEÇAN, 21 SHKURT - Komisioni për Emërtimin e Rrugëve, i emëruar nga Kuvendi Komunal i Deçanit, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kërkesave të shumta, me propozime të emrave dhe rrugëve të paemërtuara, sipas parashtrimit të kërkesave nga qytetarët, ka filluar daljen në terren për t'i verifikuar nga afër të gjitha kërkesat dhe për ta konstatuar gjendjen faktike. Agjenda e përfundimit të vizitave në terren në të gjitha lokalitetet

vazhdon deri më 11 mars.

Komisioni në fjalë, i përbërë nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe ekspertë nga urbanizmi, do ta japë vlerësimin për gjithsecilën kërkesë në përputhje me rregullat dhe kushtet që i parashohin ligjet në fuqi.

Në seancën e Kuvendit të Komunës, të muajit mars, pritet që Kuvendi t'i shqyrtojë propozimet nga Komisioni kompetent për t'i aprovuar.

Pastaj vendimi i Kuvendit të

Komunës, sipas procedurës ligjore, dërgohet në ministritë e linjës, për t'i verifikuar a janë në përputhje me ligjet e vendit.

Pas aprovimit të ligjshmërisë, emërtimet e reja do të futen në adresarin e Kosovës dhe do të vendosen tabelat me emërtime, si dhe numrat e shtëpive.

Të gjithë parashtruesit e kërkesave do ta pranojnë vendimin me shkrim për aprovimin apo jo të kërkesës së tyre sipas rregullave dhe kushteve që obligojnë ligjet në fuqi.



Ndalohe shtatë persona për hyrje në sistemet kompjuterike, mashtrim dhe shpëlarje të parasë



PRISHTINË, 21 SHKURT - Me urdhr të Prokurorisë Speciale, Policia e Kosovës ka ndërmarrë një aksion në shtatë lokacione të ndryshme të Kosovës, ku janë arrestuar shtatë persona të dyshuar për

vepra të ndryshme penale. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës njoftojnë opinionin se gjatë këtij aksioni janë sekuestruar disa vetura, armë, municion, mjete të

konsiderueshme materiale, si dhe prova të tjera materiale të cilat dyshohen se janë përdorur për kryerjen e veprave penale. Aksioni është zhvilluar në shtatë lokacione të ndryshme me

dyshimin se personat e ndaluar janë përfshirë në kryerjen e veprave penale, "Hyrje në sistemet kompjuterike", "Mashtrimi" dhe "Shpëlarje e parave".

Guvernatori Ismaili thotë se rregullorja e re e BQK-së përfaqëson Kosovën me standardet e BE-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorin Fusha, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në vendin tonë, Olivier Guerot, i shoqëruar nga Pierre Grandjouan.

Guvernatori Ismaili e ka njoftuar ambasadorin Guerot lidhur me aktualitetet në sistemin financiar të vendit, zhvillimet makroekonomike, perspektivën, objektivat dhe planin strategjik të BQK-së, nismat për avancimin e sistemit financiar, përfshirë projektin për modernizimin e sistemit të pagesave dhe synimin për anëtarësimin në Zonën e Vetme të Pagesave Euro të Bashkimit Evropian, i njohur si SEPA. Me këtë rast, guvernatori i BQK-së ka shprehur vlerësimet dhe konsideratat më të larta për mbështetjen nga Banka e Francës, e cila ka kontribuar në projekte te ndryshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndihmën e popullit francez për popullin e Kosovës.

Në takim u diskutua edhe për avancimin e kornizës rregullative



dhe ligjore, duke përfshirë Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimin e Pagesave dhe ligje të tjera, të cilat kanë si synim përaftrimin me direktiva të BE-së. Po ashtu, është biseduar lidhur me veprimet e ndërmarra ndaj parave të

falsifikuara, si dhe planet e tjera për fuqizimin e integritetit të sistemit financiar, me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Guvernatori Ismaili e informoi ambasadorin Guerot mbi Rregulloren për Operacione me

Para të Gatshme, duke sqaruar aspektet kryesore, efektet dhe argumentet për pozicionin e saj. U sqarua se rregullorja avanco integritetin e sistemit financiar dhe përfaqëson Republikën e Kosovës me standardet e BE-së.

Ambasadori francez u njoftua edhe për planin e BQK-së për zbatimin e kësaj Rregulloreje në praktikë, si dhe veprimet për lehtësimin e efekteve të saj, krahas angazhimit konstruktiv të BQK-së për lehtësimin e transferimit të mjeteve sipas modelit të propozuar dhe gatishmërisë për të diskutuar opsionet e mundshme ligjore.

Sa iu përket shqetësimeve të ngritura lidhur me ndikimet e saj në një komunitet të caktuar, u sqarua se Rregullorja në fjalë nuk ndalon apo kufizon pranimin e mjeteve në llogaritë bankare në euro dhe as nuk kufizon aktivitetin këmbimor që kryhet nga institucionet financiare bankare ose jobankare të licencuara nga BQK.

Në fund u tha se BQK në mënyrë aktive po vazhdon aktivitetet e informimit dhe sensibilizimit, përfshirë lëshimin e linjës pa pagesë të dedikuar për qytetarët tanë dhe materiale të tjera informuese, duke i ftuar ata që ende nuk kanë llogari, të hapin një të tillë te secila bankë, e cila për grupe të cënueshme nuk ka tarifë të hapjes e as të mirëmbajtjes, nga 1 janari 2024 me rregulloren e BQK-së për Qasje në Llogari Paguese për Shërbime Bazike.

Kurti: Buxheti i komunave për vitin 2024 arrin në 742 milionë euro

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe zgjerimit të mëtutjeshëm të komunikimit si Qeveri e Kosovës, si dhe me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe kërkesave në nivelin lokal, kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe zëvendësministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, të mërkurën zhvilloi takimin e gjashtë të rregullt me kryetarët e komunave të Kosovës. "Buxheti i komunave për vitin 2024 arrin në 742 milionë euro. Gati gjysmën e buxhetit të disponueshëm qeveria ua ndan komunave. Po bëhet viti i dytë radhazi që rritja e buxhetit është në përqindje dyshifrore krahasuar me vitin paraprak. Buxheti i vitit 2024 është për gati 90 milionë euro më i lartë krahasuar me vitin paraprak 2023. Kurse nga fillimi i mandatit, për tri vite, buxheti vjetor i komunave është rritur për 195 milionë euro më shumë. Granti i Përgjithshëm për Komuna për vitin 2024 kap shumën prej 284.7 milionë



eurosh që, njëherësh, është granti me vlerën më të madhe ndonjëherë", ka thënë Kurti.

Ai ngriti për trajtim edhe dy çështje të tjera të rëndësishme: regjistrimi i popullsisë, që pritet të nisë në fillim të muajit prill dhe çështja e qenve të braktisur dhe endacakë.

Në lidhje me të parën, kryeministri u bëri thirrje të gjithëve për përkushtim dhe angazhim të përbashkët për përfundim me sukses të këtij procesi me rëndësi qenësore për zhvillimin socio-ekonomik të vendit tonë. "Politikëbërja e

bazuar në të dhëna është e rëndësishme si për nivelin qendror ashtu edhe atë lokal të qeverisjes, sepse mundëson planifikim të mirë, shpërndarje të drejtë dhe të barabartë të burimeve për arsim, shëndetësi, banim dhe punësim për të gjithë qytetarët dhe komunitetet e vendit tonë", u shpreh ai.

Ndërsa sa i përket shqetësimit në lidhje me strehimin e qenve endacakë me të cilët përballet secila komunë, ai tha se grupi koordinues që udhëhiqet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në strategjinë e tij

ka paraparë disa hapa ndërinstitucionalë, ndër to ndërtimin e strehimoreve dhe zhvillimin e shërbimeve lokale të menaxhimit të qenve. Në mesin e tyre, ndërtimin e katër strehimoreve në katër komuna: në Prishtinë, në Prizren, në Pejë, dhe Gjilan/Kamenicë, bazuar në udhëzimin administrativ aktual. Kryeministri Kurti u bëri thirrje kryetarëve dhe përfaqësuesve të komunave të bashkëpunojnë sa më ngushtë me grupin koordinues për realizimin e objektivave të synuara. Ndërkaq, ministri i Administrimit

të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, fillimisht tha se ky takim i radhës shërben si tryezë e diskutimit për ku dy nivelet diskutojnë për projekte dhe programet, të cilat sjellin zhvillimin ekonomik lokal dhe rritin mirëqenien e qytetarëve, teksa ftoi komunat t'i përgjigjen thirrjes së hapur më 15 shkurt për raportim në sistemin e performancës për vitin 2023 dhe të aplikojnë në programin për financimin e projekteve infrastrukturore pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që mbetet i hapur deri më 28 shkurt.

Për çfarë po aventurizohet partneriteti me ShBA-në?



Shkruan: Hajdin ABAZI

Për Kosovën, t'i acarojë raportet me Perëndimin përgjithësisht dhe posaçërisht me ShBA-në, do të mund të ishte e mendueshme vetëm në një rast ekstrem: po qe se do t'i kërkohet të kthehej pas nën pushtimin serb. A është duke ndodhur kjo?

Kur lexova se James O'Brian që, më 14 shkurt, tha se nëse Kurti nuk na trajton si partner, kjo ngre pikëpyetje nëse ne mund ta konsiderojmë këtë qeveri si partner, u trondita, jo se ishte e papritur - sepse sjelljet politike ndaj ShBA-së ishin konsistente në mosbashkërendim, po sepse kështu u konfirmua edhe botërisht gjendja kritike e raporteve të Kosovës me ShBA-në, e që erdhi në prag të 16 vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Mendja fluturoi në atë distancë vitesh, konkretisht në vitin 1998, kur kundërvënia e armatosur ndaj agresionit serb tashmë kishte marrë përmasa të një lëvizjeje çlirimtare. Asokohe, realisht, ne si shqiptarë e kishim të drejtën faktike në anën tonë, por Serbia ishte ushtarakisht tepër e fortë që ne të mund ta mposhtnim të vetëm atë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës i kishte dy rrugë të vetme: o të pranonte furnizime me armë nga ndonjë qeveri radikale islamike dhe të lejonte forcat ekstreme t'i bashkoheshin që të mund të luftonte kundër Serbisë, ose të zgjidhte Perëndimin, para së gjithash, ShBA. Ofertat e para ishin më të zëshme dhe më të gatshme për t'u involvuar, kurse Perëndimi dhe veçanërisht ShBA dukej ende hezituese. Liderhipi i UÇK-së me vetëdije të plotë u përcaktua për Perëndimin, si e vetnija perspektivë dhe fat jetik i saj - në frymën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe të Rilindjes Kombëtare, e kjo edhe ishte në përputhje me trendët evropian për integrim ku, herët a vonë, do të përfshihej edhe Kosova si pjesë integrale e kontinentit. Arritja e bashkëpunimit me ShBA-në ishte e zorshme, por jo dhe e pamundur dhe UÇK-ja u përcaktua pa asnjë mëdyshje për Perëndimin.

E tash, ulja e nivelit të partneritetit me ShBA nga qeveria Kurti, më solli momentin historik të rolit vendimtar të partneritetit me amerikanët. Ende më tingëllojnë fjalët dashamirëse të emisarit të asokohshëm të presidentit Bill

Clinton, ambasadorit Richard Holbrooke: *Nëse ju do të bashkëpunoni me State Departamentin amerikan dhe do të veproni ashtu si të ju themi ne, ju garantoj se Kosova do të bëhet shtet më vete!*

Sigurisht, kjo deklaratë kishte shumë thellësi përmbytësore, por edhe shumë të panjohura. Njëra prej tyre ishte, pikërisht kapaciteti luftarak i UÇK-së. Prandaj, duke e ditur nevojën e jashtëzakonshme për armatim që kishte lufta jonë çlirimtare, i thashë, ndër të tjera, se po qe se ne i humbim të gjitha betejat (për shkak të armatimit të dobët) - shuma e të cilave përbën luftën, atëherë si do të behet shtet më vete Kosova - thashë duke shprehur brengën themelore. Prisja përgjigjen se ShBA-ja nuk do ta lejojë humbjen e betejave, se do ta armatosë popullin e Kosovës. Por jo, emisari Holbrooke, tha diçka më të madhe, diçka që askush nuk e kishte thënë deri atëherë dhe askush përpara tij, e që ishte profetike: Do të ndodh diçka ashtu si nuk ka ndodhur deri më sot! Epilogu dihet: UÇK iu përmbyt partneritetit me ShBA-në, dhe ShBA-ja në krye të NATO-s bombarduan Serbinë millosheviçiane për 72 ditë derisa e bënë të kapitullojë, t'i tërheqë forcat pushtuese serbe dhe Kosova të çlirohet.

E solla ndërmend këtë insert, për të treguar se kur bashkërendohen veprimet me ShBA-në, qëllimet finale arrihen, ani se mund të duken krejt të pabesueshme ne fillim. Nuk ishte aspak e lehtë, madje ishte tepër e rëndë për UÇK-në, që të luftonte me armatim kryesisht të Luftës së Dytë Botërore ndaj një agresori me armatim modern, madje ndonjëherë edhe ishte legjitim të mendohej se athua mos po gabonim që po i besonim Amerikës. Por, shtrohet pyetja, cila ishte alternativa? Kishte, sigurisht, por asnjëra nuk ishin të duhura për shqiptarët dhe nuk kishin garancinë që i duhej Kosovës.

Po kaq e rëndë, absolutisht, madje shumëherë më e rëndë, ishte edhe qëndrimi në Rambuje sidomos i krerëve të UÇK-së për të dëgjuar ShBA-në, në figurën madhështore të sekretares Madelain Albright, që të nënshkruhej Marrëveshja e Rambujesë. Ajo, de facto, Kosovës i siguronte një lloj autonomi por jo shtetësi. ShBA-ja kërkonte t'i besohej asaj në diçka që në aparcë dukej si tradhti e idealeve çlirimtare. Por qenë dhënë premtime se po qe se do të dëgjoheshin dhe të nënshkruhej marrëveshja, atëherë Kosova do të bëhej shtet më vete!

Këto janë dy momente historike, ku shihet se besimi i shprehur ndaj ShBA-ja është kthyer me besim të plotë dhe me veprim në shërbim të lirisë, çlirimit,

pavarësisë, demokracisë, shtetbërjes dhe sigurisë, paqes e stabilitetit.

Së fundi, ju kujtohet fjalimi historik i presidentit amerikan George W. Bush në Tiranë i cili e tha pa ekuivokë: Enough is enough? Ky ishte preludi i pavarësisë së Kosovës.

Pa mbështetjen e ShBA-së, Kosova nuk do të ishte sot këtu ku është, në kuptimin se nuk do të kishte liri, çlirim, pavarësi dhe shtet.

Nëse Qeveria Kurti nuk na trajton si partner... Më qartë se kaq, nuk ka se si të thuhet. Kurti deshi, duke manipuluar me kuptimësinë, të pohojë të kundërtën, se ai bashkëpunon me ShBA-në, por shpejt erdhi demontimi nga ambasadori Jeffrey M. Havonier: *Është e pavërtetë!* Nuk është pra se ShBA-ja po do ta prishë partneritetin me Kosovën, por është e kundërta. Duket si një ëndërr e keqe, prej se cilës njeriu dëshiron të zgjohet minutë e më parë!

Disa pyetje fundamentale shtrohen në këtë gjendje: Çfarë po i kërkohet Kosovës që të shkohet deri në këtë ekstrem? Çka ka ndryshuar në konstelacionet ndërkombëtare, që Qeveria Kurti të lëndojë partneritetin me ShBA-në? Me mos bashkërendim me ShBA-në, kah po çohet Kosova, cila është alternativa?

Ajo që duhet theksuar që në fillim është se marrëdhëniet midis dy vendeve përgjithësisht, dhe të një partneriteti jetik si ai i Kosovës me ShBA-në, para se acarimet të bëhen publike, bëhet një përpjekje e fuqishme interne, me kanale shtetërore e diplomatike, për të gjetur zgjidhje. Vetëm kur ato nuk japin rezultate, mosmarrëveshjet bëhen publike. Këtë shkurt por qartë e pohoi O'Brian. Mos dëgjueshmëria apo veprimet e njëanshme sjellin pasojat! Ishte paralajmërim, nëse nuk vepron me urgjencë në sanimin e tyre.

Nga ajo që është thënë publikisht deri më sot, nuk na ka kërkuar ShBA-ja asgjë që të dëmtohet integriteti, sovraniteti dhe ekzistenca e shtetit të Kosovës. Nëse ka diçka të tillë, qeveria e ka për detyrë t'i tregojë popullit, e nëse nuk e bën këtë - ajo mban përgjegjësi.

Çështja më e mprehtë deri më tash, Asociacioni i komunave me shumicë serbe që tash nga BE është propozuar nivel autonomie, do të mund të ishte e vetnija arsye për çka do të mund të këmbëngulej në të kundërtën qoftë edhe duke i acaruar raportet me aleatët - sepse një autonomi e tillë e lëndon rëndë ekzistencën e shtetit të Kosovës. Jo, nuk është kjo, sepse për Asociacionin është pajtuar Kryeministri Kurti. Atëherë?

Bëhet fjalë për disa veprime që nuk ishin aq imediate, aq të

Tashmë dihet se Serbia ka resurse, përvore dhe mbështetje nga shtete e shërbime të shumta, që janë armiqësore ndaj Kosovës, dhe ajo po bashkërendohet në këto konstelacione, sa ndonëse në veprime është gabim dhe është shkaktare reale e tensioneve, konflikteve dhe edhe e nxitjeve për luftë, po duket para botës si

më konstruktive se sa Kosova! Vuçiq shfrytëzon çdo rast për të dhënë goditje, për të prishur imazhin e Kosovës në sy të Perëndimit para se gjithash e edhe të botës në përgjithësi, për ta paraqitur Kosovën si shkaktare të tensioneve e trazirave, të cilat vet ajo i nxitë, por që Kosova po ia krijon rrethanat që asaj i duhen. Amerikanët këtë e dinë fare mirë, por ata kanë qëllime dhe plane të tjera taktike e strategjike në kuadër të gjeopolitikës perëndimore, ndaj po i kërkohen Kosovës që ajo të japë kontributin e vet duke u bashkërenduar, në stilin që mishi të piqet e helli të mos digjet!

Po Qeveria Kurti në emër të shtetit të sovranitetit, me veprimet e saja po e humb përkrahjen e partnerëve si ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania e kështu edhe nga të gjithë vendet perëndimore. A mundet kundër Serbisë të sendërtojë sovranitet Kosova pa mbështetjen e madhe të partnerëve perëndimorë? Me mbështetjen e tyre, ani me mjaft vështirësi, ngadalë, hap pas hapi e mezi po realizohet.

Kur i dëgjoj qeveritarët Kurti të flasin për sovranitetin, më krijohet përshtypja sikur ata flasin nga pozitë e një shteti superfuqi e jo nga pozita e Kosovës. Kosova shtet me dhunë nuk mund të bëhet sepse kemi një armik që është shumëherë më i fuqishëm se ne, po ne do të mund t'ia dalim vetëm me diplomaci, mençuri dhe dëgjueshmëri domethënë bashkërendim me ShBA-në.

Kur i dëgjon deklaratat e pushtetarëve në krye me Kurtin krijohet përshtypja se kanë harruar specifikën e Kosovës, faktin se ende në fuqi është Rezoluta 1244 e OKB dhe do të mbetet e tillë përderisa Kosova nuk do të pranohet anëtare e OKB. Për aq kohë sa do të jetë ajo Rezolutë në fuqi, Kosova ndodhet përballë rreziqeve ekzistenciale sepse në OKB Rusia, Kina e India hapur janë pozicionuar kundër shtetit të Kosovës dhe mund ta bllokojnë në Këshillin e Sigurimit pranimin e saj anëtar të organizatës së kombeve. Këtyre rreziqeve Kosova u ka bërë ballë vetëm në një mënyrë: duke u bashkërenduar për gjithçka me ShBA-në.

Gjendja e rreziqeve si nga Serbia ashtu edhe nga rrethanat ndërkombëtare janë po ato që kanë qenë dhe asgjë nuk ka ndryshuar në ato përmasa sa të shtrohet nevoja jetike për të rishikuar raportet e Kosovës me ShBA-në dhe për të përcaktuar një kurs të ri, një rreshtim tjetër gjeopolitik.

E pra, si në Qeverinë Kurti 1 edhe tash, sidomos tash, në Qeverinë Kurti 2, po ndodhë një proces kontinuel i degradimit të raporteve të Kosovës me ShBA-në,

në mënyrë permanente dhe sistematike, me ndonjë rast përjashtimi, dhe është i dukshëm kursi i largimit nga partneriteti më amerikanët, madje, çka është më e keqja, ky kurs tash mori përmasat e prishjes edhe me BE, me një fjalë – përgjithësisht me perëndimin. Në mënyrë logjike, dhe madje jetike, për Kosovën dhe popullin e saj shtrohet një pyetje: ku do të mbështetemi ne, ose kush do të na mbështesë neve nëse jo ShBA dhe BE? Kush mund të jetë partneri alternativ, nëse ka? E pra, historia jonë kombëtare, si ajo e Shqipërisë edhe e Kosovës, na tregon katërçipërisht se pa mbështetjen e Perëndimit, posaçërisht të ShBA-së, nuk do të kishim shtete dhe mbase ende do të ishim në rrezik ekzistencial.

Çdo shqiptar në përgjithësi e sidomos ata që merren me politikë, qoftë drejtpërdrejtë e qoftë përmes militimit në parti politike, e kanë për detyrë morale, e në disa raste besa edhe kombëtare, që të pyesin veten se kjo që po ndodhë – a është e mirë për Kosovën apo e keqe? A mundet Kosova e vetme të përballet me Serbinë në planin diplomatik e politik ne OKB?

Duket se disa janë lajthitur se do të jetë KFOR-i, domethënë NATO, ajo që do të luftojë për Kosovën. KFOR-i mund të involvohet vetëm po qe se ia mësyjnë forcat ushtarake serbe për agresion ndaj Kosovës, sepse e ka mandat (me Rezolutën 1244 sic) të mbrojtë kufijtë e Kosovës. Këtë e di mirë Serbia, dhe ajo mundet ta bëjë këtë vetëm në funksion të ndonjë plani gjeostrategjik ruso-serb. Serbia kryesisht, besoj unë, do të veprojë përmes minoritetit serb, që disa politikanë minoritar i ka instrumentalizuar me anë të përfitimeve personale, pushtetit, shantazhit, dhunës e terrorit ndaj të padëgjuarve. Pra, veprimet do të jenë nga brenda vendit, si rezistencë e serbëve lokalë, me mbështetje e propagandë nga Beogradi. Një konflikt i armatosur apo kryengritje e brendshme do të vinte para një sfide KFOR-in dhe tërë Perëndimin. Serbia sigurisht nuk i nxit në veprime vetëm kundër Kosovës, por edhe në shërbim të gjeopolitikës, të veprimeve taktike e strategjike ruso-serbe, për çka ShBA duan të mos i krijojnë favore të tilla Serbisë, me veprime të nxituara politike, ani se juridikisht ato janë të drejta dhe do të ishin krejt të duhura në një gjendje normale. Ish emisari Grenell, së voni deklaroi se ushtarët amerikan nuk duhet të vriten në Kosovë për shkak të mosdëgjimit të Kurtit, dhe sikur paralajmëroi mundësinë e tërheqjes amerikane. Vetëm edhe si deklaratë, kjo është një ogur kobshëm.

Madje, këtyre ditëve u bë krejt e qartë ajo që kryeministri Kurti ishte munduar ta turbullonte. Ai kishte thënë se ishte president Trump me të cilin nuk pajtohej dhe për ta dëshmuar këtë, kishte dalë asokohe në anën e kandidatit për president Joe Biden. Nuk

shkoi shumë dhe edhe me administratën Biden nisi degradimin e raporteve. Akrobacionet e Kurtit tashmë e kanë lënduar imazhin e Kosovës në perëndim, sa Kosova të perceptohet si fajtohet dhe besimi ndaj Kosovës te aleatët është thuar zero.

Prandaj, kushdo që mendon se u kemi mbetur në duar ShBA dhe NATO-s, të tillët nuk i kuptojnë aspak gjeopolitikën dhe gjeostrategjinë globale, po gjykojnë me kutin e provincës. Nuk është e vështirë të supozohet ndonjë situatë kur Serbia do të mund të rreshtohet me ShBA-BE dhe Kosova të binte në kurthin e vet. Në një rast të tillë, mund të merret me mend se ku do të katandisej Kosova!

Unë e kam theksuar disa herë në shkrimet e mia se Kosova çdo gjë që ka mbërri deri më tash e ka mbërri vetëm në bashkërendim me ShBA-në, dhe sa herë ka ndodhur kjo - Kosovës i ka rënë mirë. E kur nuk ndodhë bashkërendimi me ShBA – asnjëherë Kosovës, në këto rrethana për ne dhe në këto konstelacione ndërkombëtare, nuk i ka rënë mirë dhe nuk ka se si t'i bie mirë.

Një lider mund të lërë përshtypjen e një njeriu të madh, duke përcaktuar dhe ndjekur një kurs me përmasa të mëdha, por se a do të jetë i tillë apo jo nuk e tregojnë përmasat dhe përcaktimet, as retorike e lidshmit e as besimet e militantëve, por e tregojnë rezultatet, arritjet ose dështimet, ecjet përpara ose ecjet pas. Qeverisë Kurti i dolën kundër aleatet më të ngushtë dhe e tërë bota në Këshill të Sigurimit. Kjo nuk është sukses, por dështim.

Po qe se u hidhet një sy qëndrimeve virtuale në rrjete të ndryshme sociale, por edhe deklaratave të niveleve të ndryshme të politikanëve në pushtet, nuk është e zorshme për ta shquar se ata ndjehen krenar që doli një njeri që i kundërvihet edhe perëndimit, sepse kjo ju ka munguar të gjithë liderëve paraprak të Kosovës. Një krenari delirante, që kënaqet kur duhet t'i thirret mendjes!

Si mund të mbrohet shtetësia e Kosovës, vallë, sot, po qe se i çojnë duart nga ne ShBA dhe BE?

Kush nuk e merr parasysh faktin se Kosova është në një rrethanë kur ekzistenca e saj mund të vihet fare lehtë në pikëpyetje, dhe të drejtën e ligjet i konsideron si të mjaftueshme për t'i bindur të tjerët dhe për të fituar mbështetje – ka keqperceptim të realitetit gjeopolitik. Këtë e tregoi mbledhja e Këshillit të Sigurimit, e thirrur nga Serbia për çështjen e dinarit, ku të gjithë aleatët perëndimorë e kritikuan Kosovën. E qartë: veprimet e njëanshme mund të kenë pasojë dhe të prekin kualitetin e raporteve të Kosovës me perëndimorët.

Në mënyrë delirante pushtetarët po tregojnë kujdes që ta



përshkallëzojnë konfrontimin me ShBA-në dhe me Perëndimin. Deklarimet e fundit të B. Bislimit kundrejt ambasadorit amerikan Hovenier dhe kundër BE, janë një maskaradë e vërtetë politike. Këtij deliri i bashkëngjiten edhe disa deputet të pushtetit. Në vend që të reflektohet dhe të bëhet një tërheqje e mençur dhe të korrektohet aq sa mund të korrektohen qëndrimet jo bashkërenduese të shprehura publikisht, lansohen qëndrime, që duket sikur ShBA-ja dhe BE-ja duhet të tmerrohen prej tyre.

Në raport me Serbinë nëse Kosova ka pasur ndonjë forcë, ajo ka qenë të morali, te vendosmëria në luftë kundër saj por edhe te mençuria për t'i bërë aleatët ta kuptojnë kauzën shqiptare. Vendosmëria për sakrificë përgjatë dekadave për liri, dhe në fund edhe rrokja e armëve nga UÇK-ja për ta luftuar agresionin serb dhe dakordimi për bashkërendim - e bindi ShBA-në që të na marrë në mbrojtje. Fuqia jonë ishte te kauzat e drejta, te bashkërendimi dhe te besimi ndaj ShBA-së dhe aleatëve perëndimorë.

Qysh Qeveria Kurti 1 dhe tash Qeveria Kurti 2 kanë shtruar kauza që në aparençë janë të drejta, por politikisht janë jo në kohën e duhur dhe jo të ishtë fjala, për shembull, për një shtet të etabluar dhe të njohur ndërkombëtarisht, puna e targave, puna e pushtetit ilegal të një shteti tjetër dhe kjo e funksionimit të një valute paralele – do të zgjidheshin ashtu sikurse Kurti po bën, duke marrë vendime dhe duke i zbatuar ato sipas ligjeve në fuqi. Por Kosova ende nuk i ka ndarë dhentë e dhentë me Serbinë në aspektin ndërkombëtar. Prandaj, në gjendjen në të cilën ndodhet Kosova, kur armiku i saj, shovinizmi serb në krye me Vuçiq, pret si hijenë në pusi për lajthitje dhe hapa që i japin pretekste veprimi kundër Kosovës, nuk do të duhej në asgjë të vepronte kokë më vete, po për gjithçka paraprakisht të bashkërendohej dhe ashtu e për aq sa të pajtohej ShBA-ja. Vetëm duke u treguar të dëgjueshëm, në kuptimin e konstruktivitetit dhe veprimit si

partner për të harmonizuar veprimet taktike në kuadër të gjeostrategjisë për Ballkanin Perëndimor, ndaj ShBA-së, si shteti që është sponsorizues i pavarësisë së Kosovës dhe shtetbërjes së saj, dhe duke vepruar ashtu sikurse të rekomandojnë amerikanët, Kosova mundet të shmang interferimet e Serbisë. Për fat të keq, sikurse po e thonë tashmë të zhgënjyer amerikanët, krejt të kundërtën po bën Qeveria Kurti. Dhe pikërisht kjo e ka acaruar gjendjen me sponsorizuesin e pavarësisë sonë, deri në atë masë sa të na thotë se do të na trajtojë ashtu sikurse Qeveria Kurti po e trajton atë!

ShBA e ka pasur të vështirë të dalë publikisht e të deklarohet për mosbashkërendimin e Kosovës, për shkak se Kosova ishte storie e suksesit e ShBA-së për lirinë e popujve të vegjël, por erdhi gjendja deri aty sa u detyruan ta bëjnë. Dhe kjo, kuptohet, shpreh rëndien e kualitetit të marrëdhënieve midis dy vendeve në nivelin më të ulët ndonjëherë. Kujt nuk i kujtohen vallë deklaratat e fuqishme të Escobar, i cili thoshte se asnjëherë ShBA-ja nuk ka bërë asnjë veprim që do ta dëmtonte Kosovën. Po të kishte diçka të kundërt, do të duhej Kurti të dilte e ta thoshte. ShBA-ja ka strategji afatgjata e të përmasave globale, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor, e ne jemi në kuadër të saj, por që roli ynë mund të jetë i madh dhe produktiv, ashtu sikurse është roli i Shqipërisë, po qe se do të ishim konstruktiv, luajalë dhe bashkërendues. Ose mund të jetë e kundërta siç po ndodh.

Ajo që kërkohet është që Kosova të jetë krah ShBA-së në gjeopolitikën dhe gjeostrategjinë e saj. Ndryshe, jemi gabim. ShBA-ja mund të gjejë partner alternativë, por ne nuk mund të gjejmë një ShBA alternative. Sidomos jo pasi e kemi humbur besimin te Perëndimi. Sepse cili vend do të jetë ai që do të thotë se duhet ta mbështesë Kosovën, kur kjo ia ktheu shpinën ShBA-së dhe i shkaktonte probleme kur duhej t'i evitonte

ato?


Besimi është një vlerë e madhe në Perëndim. Ju kujtohet presidenti Macron kur e tha në Tiranë se Kurti është treguar i pabesë. Ajo ishte një paralajmërim, se nëse nuk ka besueshmëri në partneritet, atëherë sjelljet ndryshojnë. Dhe, një shembull, i thjeshtë janë sanksionet që ju vendosen Kosovës, madje pa i quajtur sanksione. Por mund të ketë edhe më keq, dhe kjo mund të na pres, po qe se vazhdon arroganca qeveritare. Kur nuk ka besueshmëri dhe partneritet, gjërat nuk diskutohen, por diktohen!

Ardhja e Kurtit në pushtet po ju kthehet si bumerang të gjithë atyre shteteve që e kanë mbështetur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të cilat duket se kanë bërë kalkulime të gabuara. Por, ndonëse po ju kushton edhe atyre, faturën kryesore do ta paguajë Kosova.

Serbia po manovron me Perëndimin, duke bërë një lloj flirtimi, kurse sjelljen reale e ka me aleatët e saj strategjikë, Rusinë, Kinën e Indinë me të cilët vetëm sa po i forcon bashkëpunimet. Së fundmi, edhe mundësia për futje në BRICS, një mekanizëm drejtpërdrejt anti-amerikan, shpalos mundësi gjeopolitike antiperëndimore. Vuçiq, në mënyrë besnike dhe kundër Perëndimit, nuk ka vënë sanksione ndaj Rusisë për shkak të agresionit ndaj Ukrainës. Ai po i përballon gjithë këtë presion, por nuk po ia kthen shpinën aleatit të vet rus. Po, Vuçiq luan, dhe mund të luajë, me Perëndimin sepse ka tre aleatë alternativë që janë superfuqi. E Albin Kurti, si kryeministër, duhet t'i tregojë popullit shqiptar se cilët janë aleatët tanë alternativë?

Nëse nuk ka, dhe jam i bindur se nuk ka, atëherë të ndalojë kursin e largimit, ta ndryshojë drejtimin dhe të behet një bashkërendues me ShBA-në. Shprehja si të na trajtojë, do ta trajtojmë - e lë ende mundësinë hapur për kthim e normalizim. Nëse kjo nuk ndodhë, pasojat do të bien mbi Kosovën, por as shkaktarët nuk do t'ia dalin paç.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kuvendi i Punës i FBK-së mbahet më 6 mars

PRISHTINË, 21 SHKURT - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin e Kosovës dhe, ndër të tjera, ka vendosur që Kuvendi i Punës i FBK-së të

mbahet më 6 mars në "Innovation & Training Park Prizren" (ITP).

Bordi i FBK-së e ka miratuar Raportin e Auditorit për vitin 2023, derisa e ka emëruar Lorik Klllokoqin, përzgjedhës të Kosova U18 Femrat dhe

ndihmëstrajnerë të parë e ka emëruar Aurora Muhaxherin, ndërsa Dorant Hanën e ka emëruar ndihmëstrajner të dytë të Kosova U16 Meshkujt.

Bordi në fjalë i ka miratuar propozim-ndryshimet në

Rregulloren për Organizim të Brendshëm të FBK-së. Po ashtu, e ka miratuar kërkesën e basketbollistit të Kosova 3x3, Bardh Rexha, si dhe ka miratuar kërkesën e KB Hyjnesha për regjistrim për garim në edicionin 2024/25.



Drita mposht Ballkanin, gara për titull bëhet edhe më interesante

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Gara për titull të kampionit në Superligën e Kosovës në futboll është bërë edhe më interesante, pasi skuadra e Dritës e ka mposhtur në derbin e javës së 21-të Ballkanin e Suharekës dhe tash diferenca mes tri skuadrave të para në renditjen tabelore është katër pikë, por Llapi ka një ndeshje më pak dhe kjo diferencë mund të shkurtohet në vetëm një pikë.

Pjesa e parë e derbit në Gjilan përfundoi me rezultat 0-0, derisa në minutën e 62-të Juan Mesa e kaloi skuadrën vendase në epërsi. Rastet në vazhdim nuk munguan, por ndeshja përfundoi me këtë rezultat.

Ballkani është në vendin e parë me 44 pikë, kurse Drita në vendin e tretë me 40 pikë.

Fitore të rëndësishme dhe të dytë në këtë edicion në përballje direkte



arriti Malisheva ndaj Prishtinës me rezultat 0-2. Në minutën e 33-të Altin Aliu realizoi për 0-1, kurse dy minuta pa përfunduar ndeshja rezultatin final 0-2 e vulosi futbollisti në topformë Drilon

Hazrollaj. Malisheva me këto tri pikë ngrahet në kuotën e 35 pikëve dhe zë vendin e katërt, kurse Prishtina ka pesë pikë më pak dhe renditet një vend më poshtë në renditjen tabelore.

Në ndeshjen e tretë që u zhvillua të mërkurën mes Feronikelit 74 dhe Gjilanit nuk pati fitues, pasi ndeshja përfundoi me rezultat 0-0. "Nikli" është në vendin e shtatë me 23 pikë, ndërsa Gjilani në vendin e

tetë me 21 pikë.

Sot (e enjte) në Superligë do të zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera. Fushë-Kosova ka punë shumë të vështirë ndaj Llapi që në këtë ndeshje hyn për fitore në mënyrë që ta ngushtojë sa më shumë diferencën me kryesuesit e Ballkanit, derisa "Pampurat" janë në vendin e parafundit dhe kërkojnë pikët e shpëtimit në secilin ndeshje.

Në përballjen tjetër mejejanin do të ndajnë Dukagjinin i Klinës dhe Lira e Prizrenit. Në xhiron e kaluar të dyja këto skuadra kanë pësuar humbje dhe tash kërkojnë këndelljen.

SUPERLIGA

Prishtina - Malisheva	0-2
Drita - Ballkani	1-0
Feronikeli 74 - Gjilani	0-0

Të enjten takohen:
13:00 Fushë Kosovë - Llapi
13:00 Dukagjini - Liria

Kosova U17 pëson humbje të thellë nga Finlanda



PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e vajzave e grupmohës nën 17 vjeç ka zhvilluar ndeshjen e parë në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2024 që po mbahen në Portugali. Kosova, e cila ndodhet në Grupin 2 të Ligës A, pësoi humbje me rezultat të thellë nga Finlanda (5-0). Finlandezet e siguruan epërsinë sapo filloi

ndeshja, saktësisht në minutën e shtatë realizoi Todoshchenko. Në minutën 48 u akordua penallti për finlandezet, por gjuajtjen e Olivia Ulenius e priti portierja Leyla Gërvalla. Megjithatë, vetëm një minutë më vonë Finlanda e gjeti rrugën e golit përmes Laura Oksanës. Përzgjedhësja Sanije Krasniqi u mundua që me zëvendësime ta ndalë kundërshtarin, por as kjo formulë nuk pati sukses.

Kështu, në minutën e 71-të Finlanda realizoi golin e tretë përmes Jelena Todoshchenkos, e cila shënoi tre gola në këtë takim, pasi realizoi edhe në minutën e 76 për 4-0. Ndërkohë, rezultatin përfundimtar 5-0 e vendosi Bella Aalto në minutën e 77. Ndeshjen e radhës "Dardanet" e zhvillojnë të shtunën nga ora 12:00, ku i pret një sfidë edhe më e vështirë kundër Portugalisë nikoqire.

Batatina: Kosova s'ka nevojë të mendojë për sulmues dhe qendërmbrojtës

PODUJEVË, 21 SHKURT - Trajneri i Llapi, Tahir Batatina, nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka thënë se Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nuk ka nevojë të

mendojë për sulmues dhe mbrojtës, pasi tash i ka në gjirin e vet. "Kosova nuk ka nevojë të mendojë për sulmues dhe as për qendërmbrojtës sepse tash i

ka në gjirin e vet. Muriqi dhe Hyseni, tandemi më i mirë, Rrahmani, Krasniqi dhe Dellova, një treshe që pak përfaqësuese e kanë", ka shkruar Batatina, i cili kishte

shpallur kandidaturën për selektor të "dardanëve", por Federata e Futbollit e Kosovës vendosi që këtë pozitë t'ia besojë gjermanit Franco Foda.



Haalandi vendos rekord të ri në Ligën Premiere

Manchester, 21 shkurt - Sulmuesi Erling Haaland ka shtuar një tjetër arritje mbresëlënëse në rekordin e tij duke shënuar në fitoren e fundit të Manchester Cityt në Ligën Premiere kundër Brentfordit (1-0). Për 70 minutat e para, City u

përpoq të depërtonte në mbrojtjen e Brentfordit, pavarësisht se dominonte topin, por goli erdhi kur Haalandi shfrytëzoi një gabim nga Kristoffer Ajer i Brentford, duke e kaluar me qetësi topin pas Mark Flekken. Ky gol ishte i pari për

Haalandin kundër Brentfordit dhe zgjeroi rekordin e tij të jashtëzakonshëm. Sulmuesi norvegjez ka shënuar kundër 22 skuadrave me të cilat është përballur në Ligën Premiere, duke shënuar gjithsej 53 gola në 55 paraqitje në ligë. Edhe pse

goli i dytë nga Haalandi u anulua nga VAR-i, goditja e tij fillestare siguroi një fitore 1-0 për Cityn, duke e zgjatur ecurinë në 10 ndeshje pa humbje në Ligën Premiere. Ndikimi i Haalandit vazhdon të jetë një faktor kyç në suksesin e Cityt këtë sezon.



Bayerni konfirmon largimin e Tuchelit më 30 qershor

MUNCHEN, 21 SHKURT - Pas thashethemeve nga mediet gjermane tashmë është zyrtarizuar: Thomas Tuchel do të largohet nga Bayern Munchen në fund të sezonit. Lajmi është bërë me dije nga klubi bavarez përmes një komunikate. "FC Bayern Munich dhe trajneri Thomas Tuchel kanë vendosur t'i japin fund bashkëpunimit, i cili fillimisht do të përfundonte më 30 qershor 2025, por tashmë është vendosur më 30 qershor 2024. Ky është rezultati i një bisede miqësore midis CEO-s Jan-Christian Dreesen dhe Thomas Tuchel", thuhet në deklaratën për shtyp të Bayernit.

"Në një bisedë të hapur dhe pozitive ne kemi marrë vendimin për ta përfunduar reciprokisht bashkëpunimin tonë në verë. Qëllimi ynë që të arrijmë një



riorganizim sportiv me një trajner të ri për sezonin 2024/25. Deri atëherë çdo individ në klub duhet ta japë maksimumin në Ligën e Kampionëve dhe Bundesligë. Sidomos në Ligën e Kampionëve.

Jemi të bindur që, pas humbjes 0-1 në ndeshjen e parë në Lazio, në ndeshjen e kthimit në 'Allianz Arena'-n tonë të mbushur plot, ne do të arrijmë në çerekfinale", ka deklaruar Dreesen.

Ngannou 'provokon' Joshuan: Eshtë më i dobët se Fury, ndaj do ta mposht

LONDËR, 21 SHKURT - Dueli i peshave të rënda në boks mes boksierit britanik Anthony Joshua dhe sfidantit kamerunas Francis Ngannou, më 8 mars, do të jetë përballja e dytë në ring për ish-kampionin e botës në artet marcialle mikse. Tetorin e kaluar Ngannou bëri debutimin e tij në ring kundër kampionit të peshave të rënda në WBC, Tyson Fury. Në një meç me 10 raunde, pa titull, Ngannou tronditi botën kur hodhi Fury në tapet në raundin e tretë. Gjithsesi, në fund, Ngannou e humbi duelin me vendim jounanim. Ngannou mendon se Fury është një boksier më i mirë se Joshua dhe se synon ta fitojë këtë përballje të dytë në ring. "Joshua nuk është aq i fortë sa Tysoni. Mendoj se Fury është një nga personat më rezistent dhe kjo nuk është një mungesë respekti për Joshua". Kur u pyet nëse ai ka ndonjë rezervë për të luftuar me Joshuan, Ngannou është



përgjigjur: "Isha unë ai që e kërkova këtë luftë. E pashë Joshua duke dueluar dhe më pas bëra një postim në Twitter. Pashë se kishte një mundësi dhe unë e di që ai do të luftonte me Deontay Wilder, por pashë një mundësi atje për të fituar". "Kjo është ndeshja ime e dytë si boksieri profesionist dhe

unë po luftoj një nga më të mirët e viteve të fundit, një ish-kampion bote. Joshua është një nga tre më të mirët, pasi kam luftuar me një tjetër më parë. Kështu që, në dy nga luftimet e mia në boks do të luftoj më të mirët potencialisht në botë", ka deklaruar Ngannou.

SHKURT

Ducati bën ligjin në testet e fundit zyrtare

Më 9 mars do të nisë sezoni 2024 në Moto GP. Skuadrat kanë mbyllur testimet në pistën e Losail (Katar), aty ku dhe do të zhvillohet gara e parë sezonale. Testet kanë konfirmuar dominimin e motorit italian "Ducati", që duket se edhe këtë sezon do të jetë favorit për titullin për konstruktorë. Kampioni i botës në fuçi, italiani Francesco Bagnaia (Ducati), regjistroi kohën më të shpejtë në prova, 1'50"952, duke qenë edhe rekord për këtë pistë. Pas tij është shoku i tij i skuadrës, Enea Bastianini, çka tregon se ata do të duelojnë fort për titullin këtë sezon. "Janë thjesht teste, ta shohim garën e parë", u shpreh Bagnaia, që nuk kërkoi të krijojë eufori. Mirë u paraqitën në teste edhe dy motorët "satelitë", Ducati Gresini e Ducati Pramac, ku spikati Marc Marquez, që debutoi me motorin italian. Një ritëm të mirë kishte edhe motori Aprilia.

Allegri: Titulli ishte një ëndërr, ta ruajmë vendin e dytë

Juventusit në tri ndeshjet e fundit ka fituar vetëm një pikë dhe në këtë mënyrë zbehet përfundimisht ëndërra e çdo tifozit të "Zonjës së Vjetër" se mund të rivalizonin me Interin në garën për titull. I dorëzuar në këtë pikë është edhe trajneri Max Allegri. "Titulli ishte një ëndërr e bukur, por tani mjaft. Te Juventus nuk duhet të kënaqesh kurrë, në të njëjtën kohë askush nuk duhet të qëndrojë i qetë, të relaksohet, pasi duhet ta blindojmë vendin e dytë, objektiv ky që nuk është i sigurt. Ky është objektiv ynë. Duhet të luftojmë për të", mësohet t'i ketë thënë Allegri ekipit në dhomat e zhveshjes. Me këto fjalë Allegri u përpoq ta shkund ambientin, t'i kthejë sa më shpejt në shinat e duhura pasi Milani ka vetëm dy pikë larg.

Simeone: Nuk guxojmë t'i lejojmë kaq shumë raste kundërshtarit

A Atletico Madridi pësoi humbje me rezultat minimal 1-0 nga Interi në ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve, por trajneri Diego Simeone ka thënë se skuadra e tij nuk guxon t'i lejojë aq shumë raste një kundërshtari siç është Interi. "Nuk mund t'i lejojmë një ekipi të fortë si Interi kaq shumë raste. Nuk mund t'i japim kaq shumë mundësi një ekipi që del shumë mirë përpara. Gjithsesi, përtej asaj që dhuroam këtu, tani duhet të punojmë shumë për ndeshjen e kthimit, për të kaluar këtë turn. Kemi mjaftueshëm kohë për të përgatitur si duhet këtë ndeshje. Shpresoj që të rikthehen të gjithë sulmuesit, jo vetëm Morata", ka thënë Simeone.

Inzaghi: Performancë e shkëlqyer, keq që shënuam vetëm një gol

Skuadra e Interit e fitoi 1-0 ndeshjen e parë kundër Atletico Madridit në "San Siro", duke hedhur një hap drejt çerekfinaleve. "Performancë e shkëlqyer nga djemtë, që ishin të jashtëzakonshëm kundër një kundërshtari të madh. Keqardhja është që fituam vetëm me një gol diferencë. Në Madrid do të jetë vërtet e vështirë. Jam i lumtur për Arnautoviçin, për mënyrën se si hyri dhe si po punon në stërvitje. Ne nuk patëm një pjesë të parë të mirë, edhe pse mund të kishim shënuar. Më pas, në pjesën e dytë, ishim sensacionalë dhe kushdo që hyri në lojë na dha një dorë të madhe", ka thënë Inzaghi.

Unitedi, 200 milionë për Viniciusin

Vinicius Junior mund të largohet nga Real Madridi në afatin kalimtar të verës, kur edhe pritet t'i bashkohet Kylian Mbappe. Tani që skuadra e Real Madridit ka

siguruar Kylian Mbappen për vitin e ardhshëm, janë të shumtë ata që pyesin se si do të jetë bashkëjetesa me yjet e tjerë të skuadrës "Los Blancos". Madje ka nga ata që

thonë se 23-vjeçari brazilian Vinicius Junior mund ta lërë Madridin. "Le10Sport" raporton se skuadra e Manchester Unitedit synon t'i bëjë përpjekjet

maksimale për të kryer një propozim marramendës për Vinicius. Një ofertë që do të arrinte në 200 milionë euro për anësonin brazilian, që ka një kontratë deri

në vitin 2027 me Realin. Me shumë gjasë, skuadra madriline do të refuzojë çdo ofertë për Viniciusin, por anglezët do të përpiqen.

**NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË
"Beverly Park Residences " LLC
NUI: 812035568**

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuara dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë "Beverly Park Residences" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2, me numër unik identifikues 812035568 ("Shoqëria") ka nxjerr:

**VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË me datë 21/02/2024**

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 465,000.00 EURO përkatësisht nga vlera e regjistruar **3,758,000.00 Euro në 3,293,000.00Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvoglim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"Beverly Park Residences" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatlum Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e Q.A.M.P-Qendra Didaktike-Elektroinstalues në Gjakovë.

- Edon Gjini nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. III e SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Leon Kadrijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Dogana.

- Shpend Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Fitim Dervishi shpall të pavlefshme certifikatën Mbi Aftësimin Profesional të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale (Q.R.A.S).

- Petrit Kameri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12 të sh.m.p. "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshohet banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

